



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 01/51  
Datë: 23.01.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 janar 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 50 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/51


Datë: 23.01.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 janar 2009, mori

**V E N D I M**

1. Nga 1 Janari i vitit 2009 do të ketë rritje prej 5 (pesë) Euro, për këto kategori të skemave pensionale dhe sociale në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale :
  - a) Skema e Pensioneve Bazë
  - b) Skema e Pensioneve Kontribut-Pagues
  - c) Skema e Pensioneve të Aftësisë së Kufizuar dhe
  - d) Skema e Asistencës Sociale.
2. Fondet për rritje të skemave pensionale dhe sociale janë të ndara në programet përkatëse në Buxhetin për vitin 2009, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
3. Për të gjithë të punësuarit në Administratën Publike që paguhen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, prej 1 janarit 2009 do të ketë rritje të pagës bazë për 10% nga fondi për rritje të pagave prej 13.839.941 Euro.
4. Nga kjo rritje përjashtohen :
  - a) të gjitha shtesat që marrin të punësuarit në Administratën Publike;
  - b) të gjithë të punësuarit tjerë që marrin paga fikse e që janë përcaktuar me vendime të veçanta nga ish Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, Qeveria, Kuvendi i Republikës së Kosovës. Këtu bëjnë pjesë agjencionet, rregullatorët, bordet e pavarura, drejtorët e emëruar nga kryetarët e komunave;

- c) të punësuarit, pagat e të cilëve janë përcaktuar me ligj të veçantë;
  - d) mësimdhënësit dhe punonjësit tjerë të arsimit të cilët kanë përfituar nga projekti i licencimit për vitin 2008;
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
  6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/51

Datë: 23.01.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 janar 2009, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Rregullorja Nr. 01/2009 për Organizimin dhe Punën e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/51

Datë: 23.01.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 janar 2009, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/51

Datë: 23.01.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 janar 2009, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/51

Datë: 23.01.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 janar 2009, mori

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 100.000 (njëqindmijë) Euro me qëllim të renovimit të shtëpive të dëmtuara në lagjen Kroi i Vitakut, në Mitrovicë.
2. Mjete financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi sigurohen nga Fondi Rezervë i Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.
3. Menaxhimi dhe administrimi i këtij projekti të ndihmës për renovimin e shtëpive të shkatërruara do të bëhet nga një komision ndërqeveritar në përbërje të :
  - a. Zyrës së Kryeministrit;
  - b. Ministrisë së Kthimit dhe Komuniteteve;
  - c. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
  - d. Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe
  - e. Kuvendit Komunal të Mitrovicës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 07/51

Datë: 23.01.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 janar 2009, mori

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 20.000 (njëzetmijë) Euro, me qëllim të renovimit të tërësishëm të shtëpisë së dëshmorit të kombit Hasan Ramadani.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Fondi Rezervë i Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dhe derdhen në këtë xhironlogari të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dega në Besianë : 1701200001017928 Kasabank.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/51

Datë: 23.01.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 janar 2009, mori

**V E N D I M**

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT Nr. 23/48 TË DATËS 24.12.2008

1. Pas pikës 1. të vendimit të Nr. 23/48 të datës 24.12.2008, shtohet edhe paragrafi 1.1 më këtë përmbajtje :
  - 1.1 Mjetet financiare për ndërtimin e shtatores së ish Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës z. Bill Clinton, ndahen nga Fondi " Rezervat e Paparashikuara" të ndara për vitin 2009, dhe derdhen në xhironlogarinë e Shoqatës "Miqte e Amerikës - Miqtë e Bill Clintonit " Nr.: 1501001009660807 Raiffeisen Bank.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë